

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-131/12

**Prishtinë,
1 tetor 2013**

Në çështjen juridike të:

S.M

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

Kundër

R.R

Pala përgjegjëse në kërkesë/ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët: Elka Filcheva-Ermenkova , Kryetare e Kolegjit ,Esmë Erterzi dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/R/152/2012 (dosja e rastit është regjistruar në AKP me numrin KPA10469) i datës 19 prill , 2012, pas vendimmarrjes të mbajtur më 1 tetor 2013, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e S.M e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/R/152/2012, të datës 19 prill 2012 ,sa i përket ankesës ë regjistruar në KPA me numrin KPA10469.

1. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/R/152/2012, të datës 19 prill 2012, sa i përket ankesës ë regjistruar në KPA me numrin KPA10469.

2. Obligohet pala ankuese që t'i paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej 60 (gjashtë dhjetë) euro, në afatin prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh ,nga data e marrjes së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 07 dhjetor 2007, S.M e ka paraqitur kërkesën në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri posedimin e pronës-banesës që gjendet në Viti, rruga e Car Dushanit, ndërtesa P+4 banesa nr.16, në sipërfaqe prej 52,31m². Ai pretendon se ka qenë pronar i kësaj banese sipas kontratës së blerjes së banesës të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Viti, Vr.nr 735/93 i dt. 22.qershor.1993.

Ai pretendon se banesën e ka humbur për shkak rrethanave të konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë, duke theksuar datën e humbjes me 1 qershor 1999.

Kërkesa është regjistruar me numër KPA10469

Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një sërë dokumentesh tjera, por që nuk janë relevante për këtë çështje juridike.

Kontrata e blerjes së banesës të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Viti , Vr.nr 735/93/99 i dt. 22 qershor 1993, është verifikuar pozitivisht sipas raportit verifikues i AKP-ës i dt. 21 shkurt 2008.

Më 25 janar 2008, zyrtarët e AKP-së shkuan te vendi ku ndodhej objekti banesor dhe konstatuan që ai shfrytëzohej nga pala përgjegjëse në kërkesë e cila ka kërkuar të drejtën ligjore duke nënshkruar njoftimin e pjesëmarrjes.

Me dt.17 qershor 2008 pala përgjegjëse në kërkesë duke marr pjesë në procedurën e AKP-ës, ka pretenduar të drejtën ligjore të kësaj banese.

Për ta mbështetur pretendimin e tij i ka paraqitur këto dëshmi edhe atë:

- Aktvendimin e Kuvendit të Komunës së Vitisë nr.04-360-60 i dt. 16 tetor 1975, me këtë aktvendim konstatohet se palës përgjegjëse në kërkesë i ndahet banesa në Viti rruga M.Tito;
- Me Kontratën e Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Komunës së Vitisë 02 nr.360-158 i dt.27 prill 1990, palës përgjegjëse në kërkesë i është ndarë banesa nr. 15 në ndërtesën banesore në Viti derisa të ndërtohet ndërtesa banesore sipas JU programit;
- Me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Serbisë në Beograd Rev.nr.1671/95 i dt.31 maj 1995, janë anuluar vendimet e Gjykatës Komunale në Viti C.nr.2/94 dhe Gjykatës së Qarkut në Gjilan AC.r.18/94 dhe çështja juridike është kthyer në rigjykim .Me këtë aktvendim është konstatuar se ajo vendoset përkohësisht në banesën kontestuese, përderisa të ndërtohet objekti i ri kur ajo do të vendoset për shfrytëzimin e përhershëm me dorëzimin e çelësave të banesës së caktuar.
- Me vendimin e HPCC/D/236/A&C i dt.06 dhjetor 2005,miratoi kërkesën e palës përgjegjëse me nr.DS200338, duke ia kthyer asaj të drejtën pronësore për pronën e kërkuar ,ndera paraqitësit të kërkesës së me nr.DS200490 për të njëjtën banesë i është i është miratuar e drejta e kompenzimit monetar; dhe
- Me vendimin e HPCC/REC/81/2006,i dt. 11 dhjetor 2006, kërkesa për rishqyrtim e S.M kundër vendimit të HPCC/D/236/A&C i dt.16 dhjetor 2005 është refuzuar si e pabazuar.

Sipas raportit verifikues i dt.21 shkurt 2008 të gjitha dokumentet e theksuara janë verifikuar pozitivisht nga ekipi verifikues i AKP-ës.

Më 19 prill 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KPCC) me vendimin e tij KPCC/D/R/152/2012, e hodhi poshtë kërkesën e S.M si çështje e gjykuar apo res judicata. Kjo me arsyetim se e njëjta kërkesë e tij e regjistruar në HPCC nr.DS200490, është shqyrtuar dhe

vendosur me vendimin e formës së prerë të HPCC/D/236/A&C i dt.16 dhjetor 2005 duke ia pranuar të drejtën e kompensimit. Ndërkaq ,sipas kërkesës së palës përgjegjëse Rufadije Rexhepit me kërkesën e regjistruar DS200338 me të njëjtin vendim i është kthyer pranuar e drejta e pronës për banesën që është objekt i kërkesës, sipas Nnenit 14.4.C të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Më 13 shtator 2012, vendimi iu dorëzua S.M dhe i njëjti ushtroi ankesë në Gjykatë Supreme me 09 tetor 2012(në tekstin e mëtejme: pala ankuese). Me 01 tetor 2012 vendimin e pranoi R.R në cilësinë e palës përgjegjëse në kërkesë.

Me dt. 04 dhjetor 2012 pala përgjigje në ankesë ka paraqitur përgjegjëse në ankesë.

Paraqitësi i ankesës e kundërshton vendimin ankimor për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit material. Ai pretendon se e ka blerë banesën e kërkuar në mënyrë të ligjshme duke paguar në tërësi çmimin e shitblerjes. Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që duke ia pranuar ankesën t'i mundësohet e drejta e banimit në banesën që është objekt i kërkesës.

Pala përgjegjëse në ankesë i propozon Gjykatës Supreme të aprovojë vendimin, ngase ai është marr me vërtetim të drejtë dhe të plotë gjendjes faktike dhe zbatim të drejtë të drejtës procedurale dhe materiale. Ajo ka theksuar se vendimi i organit të shkallës së parë kur ka hedh kërkesën e ankuesit me arsyetim të drejtë dhe të ligjshëm ngase, për të njëjtën çështje në mes të njëjtave palë është vendosur me vendimin e plotfuqishëm dhe formës së prerë të HPCC/D/236/A&C i dt.16 dhjetor 2005. Ajo gjithashtu ka theksuar se kërkesa për rishqyrtim e S.M kundër vendimit të HPCC/D/236/A&C i dt.16 dhjetor 2005 është refuzuar si e pabazuar. Me këto vendime palës përgjegjëse në ankesë i është pranuar e drejta e pronësisë, ndërkaq ankuesit e drejta për kompensim.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pranueshme ngase është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).

Pas shqyrtimit të shkresave të lendes, pretendimeve ankimore ,sipas dispozitave të nenit 194 të LPK-ës Gjykata Supreme gjeti se: ankesa është e pabazuar.

Gjykata Supreme vlerëson se vendimi ankimor është i drejtë dhe ligjshëm. Drejtë ka vepruar KPCC kur ka vendosur me vendimin ankimor që ta hedh kërkesën e S.M për shkak të çështje së gjykuar apo res judikata sipas nenit 14.4.C të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, KPCC. Kjo ngase, kërkesa e ankuesit është shqyrtuar dhe vendosur me vendimin e plotfuqishëm dhe formës së prerë të HPCC/D/236/A&C i dt.16 dhjetor 2005 .

Kërkesa e paraqitësit të kërkesës për rishqyrtimin e këtij vendimi tanimë ishte refuzuar me vendimin HPCC/D/236/A&C i datës 16 dhjetor 2005. Pra për të njejtën çështje në mes të të njejtave palë dhe për të njejtën bazë faktike dhe juridike, është vendosur me vendimin e plotëfuqishëm dhe të formës së prerë HPCC/D/222/2005/AC, i datës 22 tetor 2005. Kjo ngase, ky vendim është vërtetuar me vendimin HPCC/REC/81/2006, i datës 11 dhjetor 2006, me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të palës ankuese.

Me këtë vendim të HPCC-ës palës përgjegjëse në ankesë i është pranuar e drejta pronësore në banesën që është objekt i kërkesës dhe e njëjta i është kthyer në posedim, ndërkaq, palës ankuese i është pranuar e drejta e kompensimit për banesën e kërkuar. Pra, ekziston vendim përfundimtar për të njejtën çështje, midis palëve të njëjta, në bazën e njëjtë faktike dhe ligjore.

Objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit të Gjykatës Supreme ishin pretendimet ankimore të ankuesit, i cili prtenedon se ai e ka blerë dhe ka paguar çmimin e shitjes së banesës së kontestuar duhet t'i mundësohet e drejta e banimit të ,por gjeti se të njëjtat janë pabazuara të papranueshme dhe rrjedhimisht të kundërligjshme. Prandaj, KPCC-ja në mënyrë të drejtë ka hedhur kërkesën e S.M-it.

Këto pretendime ankimore janë shqyrtuar , vendosur me pranimin e së drejtës për kompensim, me vendimin HPCC/D/236/2005/A&C i dt. 16 dhjetor 2005 i cili vendim është *res judikata* apo çështje e gjykuar . Më tutje neni 166 i LPK-ës, i cili *mutatis mutandis* zbatohet sipas nenit 13.5 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 parashikon se nuk lejohet gjykimi i ri në mes palëve të njëjta për çështjen juridike ,për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë, siç është.

Rrjedhimisht mbi të mësipërmen e me zbatim të nenit 13.3.B të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe nenit 166 par 2 të LPK-ës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Prandaj zbatohet, tarifa e pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): € 30
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10.15, 10.21 dhe 10.1 UA 2008/2) duke pasur parasysh se vlera e pronës në fjalë por nuk mund të jetë më shumë se 30 €.

Këto tarifa gjyqësore paguhen nga pala gjyqëhumbëse. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë është jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë dhe jo më gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë. Gjyqi e cakton afatin prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh. Neni 47 paragrafi 3 parashikon që në rast të mospagesës së tarifës brenda afatit, pala duhet të paguaj gjobën prej 50% të shumës së tarifës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të caktuar, atëherë bëhet ekzekutimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it